

GJETJA
E
VENDIT TUAJ
(11)

Gjetja e vendit *tuaj*

Puna është aktivitet që ngre vetë-imazhin dhe vlerën tuaj si pjesëtar i shoqërisë. Kjo është ajo që bën integrimin ose ri-kthimin në fuqinë punëtore objektive kryesore të rehabilitimit pas dëmtimit të palcës kurrizore. Kjo gjithashtu mund të nënkuptojë kthimin në studime, ose trajnimin profesional, ose rifillimin e aktivitetit stimulues dhe atij shoqëror.

Në mënyrë paradoksale, shoqëria jonë vendos mënjanë një sasi të madhe të të hollave për rehabilitim fizik, por relativisht pak për shërbime profesionale integrale. Pas pranimit të një numri të madh të shërbimeve profesionale gjatë rehabilitimit, personat me dëmtim të palcës kurrizore shpeshherë gjejnë veten e tyre të vetmuar në shtëpi: “Unë jam i pavarur në aktivitetet e përditshme, por nuk di si të kthehem në jetën aktive, të krijoj hapësirë (vend) për veten time në shoqëri.” Shpeshherë, shërbimet nuk arrijnë tek ta. Në vend të kësaj, njerëzit me dëmtim të palcës kurrizore duhet të ndërmarrin hapat e pare, të marrin informacione dhe të gjejnë shërbime të specializuara të cilat mund tu ndihmonë. Kjo është e kundërta e asaj që ata kanë përjetuar gjatë rehabilitimit. Kjo është shkaku pse procesi në fjalë ndonjëherë duket si përpjekje e dështuar.

Dëshira për të ndërtuar jetë aktive personale dhe shoqërore për veten është ëndër që ne të gjithë e kemi, qoftë të përdorim ose jo karrocë.

.....

Kthimi në jetën aktive pas rehabilitimit

“Unë nuk do të jemë në gjendje të kthehem në vendin tim të punës: çka do të ndodhë me mua?”

“Unë nuk mund të shkoj në vendin tim të punës; aty ka shkallë. Kufizimet e mija fizike janë shumë të mëdha për të më lejuar të shkoj në vendin e punës.”

“Punëdhënësi im, gjatë rehabilitimit tim ka gjetur dikend tjetër për të më zëvendësuar.”

“Jeta ime është rënuar. Asnjëherë më nuk do të jemë në gjendje të punoj.”

Sa pyetje si këto mund të kalojnë nëpër kokën e një personi me dëmtim të palcës kurrizore gjatë rehabilitimit të tyre? Konfrontimi me paaftësitë e tyre që nga shfaqja e dëmtimit e bën më pak të rëndësishme vlerësimin e shkathtësive momentale të tyre, megjithatë kjo është ajo çka ata duhet të bëjnë. Për t’iu adaptuar këtij realiteti të ri ata duhet të shkojnë para, të gjejnë forcën brenda tyre dhe të përshtaten (ambientohen).

Shënim I autorit

Shpresohet që ky tekst të nxisë lexuesin të mendojë për gjendjen e tij dhe të fillojë të ndër marrë hapa drejt jetës aktive.

Më vonë, mund të bëhen zgjidhje më të qarta, të caktohen objektivat personale, të rifillohet jeta aktive sociale. “Çka jam I prirur të bëj në jetë?”

“Puna që ju bëni me veten tuaj” është ajo që cakton drejtimin të cilin ju merrni në jetë. Sigurimi I punës me pagesë na ndihmon të bëhemi pjesëtarë të pavarur të shoqërisë dhe nxit ndjenjën e vlerës tek ne. Kjo është çështje e dinjitetit, e vetë-respektit njerëzor. Identiteti jonë shoqëror definohet nga roli që ne përvetësojmë: ”Shiqoni, ai është programer I kopjutrit!”

Sidoqoftë, kthimi në jetën aktive nuk nënkupton vetëm gjetjen e punës me pagesë, por gjithashtu edhe përmirësimin e shkathtësive përmes edukimit ose trajnimit profesional, ose fitimin e përvojës përmes punës vullnetare. Këtu do të kthehemi më vonë.

Perceptimi I shoqërisë për personat me paraplegji dhe kuadriplegji është ndryshuar dukshëm gjatë 15 viteve të fundit. Për shembull, ndryshe nga sot, në vitin 1980, shumë pak njerëz me karrocë ishin të përfshirë nëpër vende të punës. Programet dhe masat e qeverisë kanë ndryshuar këtë situatë: mënjanimi I pengesave arkitektonike dhe përparimi teknologjik u ka ndihmuar njerëzve me lëvizshmëri të reduktuar të integrohen në fuqinë punëtore. Aq më tepër, shoqëria është duke kuptuar se të gjithë ne jemi të njëjtë, se të gjithë ne kemi potencial të zhvillohemi dhe se çdonjëri duhet të adaptojë zhvillimin profesional sipas gjendjes së tij / saj.

Kjo është shaku pse kthimi në shtëpi pas rehabilitimit mbetet periudhë “kritike” për rifillimin e jetës aktive në shoqëri. Ekzistojnë shumë gjëra të reja të cilat duhet përshtatur siç janë ndryshimet në shtëpi dhe të mjedisit, pasiqë ne harojmë për jetën jashta, e veçanërisht nëse çështja e punësimit asnjëherë nuk është shfaqur gjatë rehabilitimit. Për këtë arsye, bëhet e domosdoshme që brenda vetes suaj të gjeni forcën e nevojshme për të ndër marrë hapat e pare në drejtim të punësimit.

Mbajtja e kontakteve gjatë rehabilitimit, qoftë përmes këshilluesit tuaj ose barazvlerësit (personit që ka përvojë në këtë) I cili ka qenë i suksesshëm në integrim mund të dëshmojë si e dobishme. Ata mund të bëhen model, roli I të cilëve është t’ju stimulojnë dhe motivojnë për të ndër marrë hapat e para.

.....

A është e realizueshme kjo ëndër?

Në shoqërinë e sotme, kërkimi I vendit të punës duket se është një punë e vështirë. Ju duhet të përpiloni planin, strategjinë që do t’ju ndihmojë të arrini (përmbushni) qëllimet tuaja, “punën shënjestër.” Përgatitja është çelësi I suksesit. Për personin me dëmtim të palcës kurrizore, egzistojnë pengesa shtesë të cilat shfaqen që në përpjekjet e para dhe ndikojnë ashtu që shumë njerëz të heqin dorë nga kjo: paragjykimet, qasja, transporti dhe

problemet e adaptimit, etj. Gjithashtu, humbja e vetë-respektit, vetë-besimit ose reagimi negativ ndaj ndryshimeve, mund të bëhen vështirësitë më të mëdha që do të pengojnë realizimin e qëllimeve tuaja primare si: marrja e kontrollit mbi jetën tuaj.

“Nga duhet të filloj? kujt duhet t’I drejtohem? Në çfarë lloji të punës? Ku të gjej ofertat për punë? A kam aftësi për punë të tillë? A jam I gatshëm për intervistim për punë?”

Në përgjithësi, duhet të keni parasyshë që nëse ju shfrytëzoni mjete të përshtatshme për objektivat përkatëse, përpjekja juaj do të përfundojë me sukses. Sadoqë objektivat mund të jenë “konstante” për disa njerëz (p.sh.: për tu bërë programues), mjetet mund të “ndryshojnë”, kjo do të thotë, ato mund të ndryshojnë nga një individ te tjetri (p.sh.: gjatë studimeve universitare ose trajnimit profesional etj). Në përgjithësi, shumica e njerëzve me dëmtim të palcës kurrizore mund të gjejë punë pa mos u ballafaquar me barriera të pakapërcyeshme përderisa ata krijojnë strategji personale të adaptuar sipas kushteve të tyre dhe eliminojnë vështirësitë të cilat prezentojnë ato. Po, është e mundur të arrini qëllimet tuaja profesionale. “Gjatë rehabilitimit tim, asnjëherë nuk kasha ëndëruar se do të bëhem përfaqësues I shërbimeve të klientëve në bankë.” thotë Andrew, viktimë nga rrëshqitja e dëborës I cili është paraplegjik.

“Unë nuk mund të kthehem në vendin tim të punës si agjent tregtar, por duke iu falenderuar përkrahjes që morra nga këshilluesi, isha në gjendje të riorientoj veten time dhe të marr trajnim në shërbimet financiare. Tani, jam shumë I kënaqur me karrierën time të re. E dua punën që bëj dhe klientët dhe kolegët e mi më respektojnë shumë.”

“Kur punoni, çdo gjë është e mundur.”

.....

Kur duhet filluar procesin?

Në fakt, vendnisja është e ndryshme për persona të ndryshëm. Disa njerëz parashtrojnë pyetje dhe fillojnë procesin që nga rehabilitimi. Të tjerë presin të kthehen në shtëpi; ndërsa, të tjerë pas rehabilitimit do ti ofrojnë vetes një periudhë për të marrë frymë. Varësisht nga gjendja personale e çdokujt kërkohet kohë e cila duhet respektuar.

Për shkak të konkurrencës së tregut në ditët e sotme, për ndonjë person i cili më parë ka pasur pozitë, është e preferueshme mbajtja e kontakteve me punëdhënësin e tij/saj dhe informimi i tyre për përparimin e rehabilitimit. Duke bërë këtë, individi ruan të hapur linjën e komunikimit në vendin e punës dhe mund të bjerë në pajtim për kthimin eventual të tij në pozitën e tij të mëhershme në kompani.

Njerëzit e tjerë me dëmtim të palcës kurrizore nuk mund të kthehen në vendet e mëparshme të punës : ata duhet të gjejnë ndonjë punë tjetër nga punëdhënës tjetër. Njerëzit e tillë përbëjnë grupin më të madh të njerëzve joaktivë të cilët kanë dëmtim të palcës kurrizore. Gjetja e punëdhënësit të ri ose një fushe të re të aktivitetit nuk është

gjithmonë e lehtë, prandaj është për të mirën e tyre të konsultohen sa më shpejt që është e mundur me këshilluesin për karrierë (profesion) për të identifikuar aftësitë (prirjet) që ata mund të kenë dhe nëse është e nevojshme të bëjnë plane për fillimin e programeve trajnuese.

Përfundimisht, personat të cilët më parë nuk kanë qenë të punësuar duhet të fillojnë të planifikojnë procesin e kërkimit të vendit të punës me ndihmën e shërbimeve të specializuara për punësim.

Sidoqoftë, duhet të shmangen kurthe të caktuara, siç janë “shumë shpejt, shumë vonë”kthimi në punë para përfundimit të rehabilitimit, para se të arrihet pavarësia maksimale, para se të parashikohen adaptimet e nevojshme, të gjitha janë dështime “shumë të shpejta.” E njëjta gjë vlen edhe për ata të cilët presin disa vite pasi që kanë përfunduar rehabilitimin. Inaktiviteti afat gjatë, vështirëson suksesin në përpjekjet tuaja. Ju duhet të keni parasyshë që zgjedhja e momentit të duhur zmadhon shumë mundësinë e arritjes së qëllimit tuaj profesional.

.....

Gjetja e vendit tuaj në tregun e punës

Në shumë regjione të Kanadës, për njerëzit me dëmtim të palcës kurrizore ekzistojnë **shërbime të specializuara për punësim**. Ne ju rekomandojmë që ju të konsultoheni me shërbimet e këtitilla, jo vetëm për të siguruar informacione mbi mundësitë për punësim në regjionin tuaj, por gjithashtu edhe për qasje në këshillimet për karrierë si dhe për informacione profesionale dhe edukative. Aq më tepër, shërbimet e këtitilla mund të sigurojnë informacione edhe për programet federale, provinciale dhe komunle mbi ndihmën financiare për ndryshime në vendin e punës me qëllim për ta bërë atë të përshtatshëm.

Kontaktimi i shërbimit të specializuar veç ju shpien në rrugë drejt gjetjes së vendit tuaj të punës. Nëse keni vështirësi në gjetjen e burimeve në zonën tuaj, për burimet ekzistuese në afërsinë tuaj mund t’ju informojë qendra juaj regjionale për resurse humane në Kanadë, shoqata e paraplegjikëve në Kanadë, ose qendra juaj rehabilituese. Këshilluesi për punësim nga njëri prej këtyre shërbimeve mund t’ju ndihmojë të filloni procesin. Për personat me dëmtim të palcës kurrizore të cilët pranojnë ndihmë financiare nga sigurimi publik ose ai privat, është pikërisht këshilluesi I kompanisë sigurorese I caktuar për rehabilitim ai I cili do t’I drejtoj ata në burimet e përshtatshme. Disa qendra të rehabilitimit ofrojnë rehabilitim profesional dhe vlerësim për punësim si dhe shërbime referuese në përgjithësi të caktuara nga terapeuti angazhues ose ergonomisti (terapeuti për punë).

Shërbimet përkrahëse, në vetvete nuk janë zgjidhje magjike ose zëvendësime për zgjedhjen e drejtimit dhe kontrollimit të procesit tuaj. Personi me dëmtim të palcës

kurrizore ende është përgjegjës për planin e tij/saj profesional si dhe për të drejtuar këshilluesin i cili e ndihmon atë.

“Përgjegjësia e personit me dëmtim të palcës kurrizore është ajo e cila siguron funksionimin e mirë të planit profesional.”

.....

Strategjia e kërkimit të punës

Gjetja e punës në tregun e sotëm kërkon përgaditje të kujdesshme. Njerëzit përdorin shprehjet si **“metodat dinamike për kërkim të vendit të punës,”** ose **“strategji për kërkim të vendit të punës”**. Kjo i referohet përgaditjes së planit tuaj personal për hapat të cilat duhet të ndërmerren në drejtim të arritjes së qëllimeve tuaja profesionale.

1) Njiheni mirë veten tuaj

Hapi i parë bazohet në përpilimin e listës të interesave tuaja, shkathtësive dhe talenteve personale skollastike (pedante) dhe profesionale përderisa caktoni qëllimet e punësimit për ju. Njohja e mirë e vetes tuaj do t’ju ndihmojë të identifikoni fuqitë dhe dobësitë e juaja. Në këtë rast, këshilluesi i specializuar për punësim mund t’ju ndihmojë të definoni potencialin tuaj për punë në marrëdhënie me tregun prezent të punës. Kjo shpeshherë është faza në të cilën është e identifikuar nevoja për trajnim dhe gjithashtu faza kur disa njerëz vendosin të vazhdojnë edukimin e tyre për të përmirësuar shkathtësitë e tyre.

2) Mundësitë për punësim

Hapi i dytë përbëhet nga identifikimi i mundësisë për punësim në tregun e punës: definimi i mirë i profilit të punësimit bën të mundur të identifikohen punëdhënësit që bëjnë ofertë për punë. Mundësitë për punësim gjenden përmes publikimeve dhe organizatave të përfshira: reklamave në gazeta, qendrës për resurse njerëzore e Kanadës, revistave të dhomës së tregtisë, asociacionit për punësim, internetit, etj. Është shënim i rëndësishëm se vetëm 15% e të gjitha vendeve të punës reklamohen publikisht ndërsa 85% mbeten të “mshihura” nga punëdhënësit të cilët dëshirojnë të minimizojë shpenzimet dhe preferojnë “fjalën e gojës” dhe rrjetin e tyre për kontakte personale si dhe asociacionet për të plotësuar vendet e zbrazta për punë. Prandaj është mjaft e rëndësishme të jeni në kontakt me rrjetet jozyrtare të komunikimit.

Përpilimi i listës për kontakte personale e cila përfshin familjen, miqtë, fqinjët, punëdhënësit e mëparshëm, shokët e vjetër nga shkolla ose vendi i punës, paraqet një burim të rëndësishëm për informacione mbi vendet e punës të cilat eventualisht mund të bëhen të arritshme (realizueshme).

“Kjo ndodhi me ndërmjetësimin e një shoku nga vendi i mëparshëm i punës i cili mendonte se unë isha në gjendje të marr këtë vend pune si ndihmës administrativ”, thotë Denisi, paraplegjik. “Derisa isha i papunë, ai më thirri për të më treguar se në qendrën e rrjetit për rehabilitim ishte një vend i lirë pune në administratë. Pas kësaj thirra drejtorin

për resurse njerëzore dhe ia dërgova kurikulumin. Më thirrën për intervistë, dhe më pranuan në punë.”

Gjithashtu është ide e mirë të përpilohet listë e punëdhënësve në regjionin tuaj me të cilët mund të kontaktohet. Ekziston numrator i telefonave të punëdhënësve të cilët mund të sigurojnë informata të vlefshme për kompanitë shenjë.

3)Përgaditja e kurikulimit

Hapi i tretë përbëhet nga zhvillimi i strategjisë së tregut.

Kurikulumi ose resumeja (përmbledhje), duhet të shkruhet me pedantri. Mbani në mend që punëdhënësit japin përparësi për intervistim atyre të cilët në fillim lënë përshtypje të mirë, e kjo arrihet përmes mbështjellëses së letrës ose thirrjes telefonike. Në kontaktin e parë, është e preferueshme të mos përmendni që ju jeni përdorues i karrocës për të shmangur shpërthimin e diskriminimit potencial.

Mbani mend, janë aftësitë tuaja ato që ju i ofroni punëdhënësit, dhe jo paaftësinë tuaj. Sidoqoftë, kur jeni i thirrur për intervistim është mirë të përmendni këtë me qëllim që të siguroni përshtatshmërinë e vendit. Nëse vendi i caktuar për intervistim nuk është i përshtatshëm, ju mund t’i thuani punëdhënësit të takoheni në vend si (p. sh.: në ndonjë restoran aty afër ose diku tjetër.). Me një fjalë kualitetet tuaja si komunikues dhe këmbëngulja juaj janë ato që do t’ju ofrojnë mundësi për punësim.

“Nga vetë personi me dëmtim të palcës kurrizore do të varet funksionimi i planit profesional.”

4) Intervistimi

përgaditja juaj për intervistim, e cila është hapi juaj i katërt, përcakton atë se çfarë përshtypje ju krijoni. Ekzistojnë lista me pyetje të cilat zakonisht parashtrohen gjatë intervistimeve selektuese për vend pune. “Na tregoni diç për veten tuaj. Na thoni diç për përvojën tuaj për sa i përket kësaj pune. Kush janë anët tuaja të mira? Kush janë dobësitë e juaja? Etj...” shfletimi i pyetjeve të tilla të zakonshme si dhe rrëfimeve të hollësishme ju ndihmojnë të keni kujdes gjatë intervistimit. Këshilluesi juaj për karrierë mund t’ju sigurojë këtë informacion.

Gjatë intervistimit, personit me dëmtim të palcës kurrizore, pothuajse gjithmonë i parashtrohen pyetje për shëndetin ose paaftësinë e tij/saj pasiqë pjesa më e madhe e punëdhënësve pothuajse nuk dijnë asgjë për paraplegjinë ose tetraplegjinë: është detyrë e juaja të informoni ato për gjendjen tuaj. Shpjegoni se cilat gjymtyrë janë të paralizuara dhe deri në çfarë shkalle si dhe çdo problem që mund të keni. Siguroni ato se përndryshe ju jeni me shëndet të mirë dhe se kufizimet fizike mund t’i kompensoheni përmes adaptimeve ose (në përgjithësi) ndryshimeve të vogla në vendin e punës. Pas intervistimit, kërkoni të vizitoni vendin e punës me qëllim që vetë ju të vlerësoni përshtatshmërinë e vendit të punës dhe organizimin fizik të medisit punues. Gjatë kësaj vizite, punëdhënësit, mund ti ofroni sugjerime mbi atë si të organizoni (rregulloni) vendin e punës nëse një gjë e tillë është e nevojshme.

Shkurimisht, shpeshherë është qëndrimi juaj gjatë intervistimit ai i cili do të përcaktojë suksesin tuaj.

Merrni qëndrim pozitiv. Vënien në dukje të përcaktueshmërisë dhe interesit tuaj në punë dhe kompani do të zmadhojë dukshëm mundësitë e juaja për të siguruar pozitë.

“Kur ai më pyeti pse dëshiroja punë si llogaritar”, thotë Gilles i cili është paraplegjik si rezultat i aksidentit me motoçikletë, “e përsërita që vetë të punuarit për kompani të re ishte sfidë me të cilën mund t’ia dilja mbanë dhe se me padurim prisja për të qenë në gjendje të vë në praktikë programet të cila i kam studiuar gjatë trajnimit tim. Gjithashtu thashë që preferoj të jemë ndër ata që do të zbatojnë sistemin e ri të llogaritjes. Punëdhënësi vuri re se unë isha i gatshëm të bëj përpjekjet të cilat kërkoheshin për atë vend pune. Jam i sigurtë që kjo i priu të fitoja këtë vend punë dy vite më parë.”

Pas testimit ose intervistimit, është e mirë të kontaktoni punëdhënësin për të kuptuar se çfarë vendimi është marrë, dhe nëse ju kanë dëgjuar ose jo. Pa marrë parasysh se kush është vendimi, mbeteni i sjellshëm, meqenëse gjithmonë është e mundur që kurikulumi juaj të jetë ruajtur në dosje për pozita të tjera në të ardhmen. Për punëdhënësit është punë e zakonshme të mbajnë një numër emra të kandidatëve për pozitën në të ardhmen. Kjo kursen kohën dhe të hollat e punëdhënësve.

5) Kontaktoni me punëdhënësin

Gjatë hapit ose fazës së pestë, ju do të vini në kontakt të drejtpërdrejtë me punëdhënësit, qoftë përmes telefonit, postës, ose më mirë, përmes prezentimit tuaj personit që ndodhet në krye të resurseve njerëzore: kjo quhet qasje proaktive. Në vend që vetëm tu përgjigjeni shpalljeve për punë, mundoheni të krijoni ndonjë lidhje me organizatat ose kompanitë ose me organizatat të cilat i keni shënuar që më parë dhe që kanë të vendosur emrin tuaj në bazën e të dhënave për kandidatët e ardhshëm. Kjo është një mënyrë e zmadhimit të mundësive tuaja për të qenë i ftuar në intervistim. Ju gjithashtu mund të kërkon vizita për kompanitë shënjestër për të ditur më shumë për shërbimet ose prodhimet e tyre.

Nëse ju duhet të merrni pjesë në ndonjë lloj testimi mbi aftësinë (prirjen), pyete personin që është përgjegjës për testimin, për të adaptuar administrimin e këtyre testeve për gjendjen tuaj fizike. Për shembull, personi me kuadriplegji mund të kërkojë që për testin me shkrim të përgjigjet me gojë, ose të kërkojë më shumë kohë për të shkruajtur testin, kështu që ata nuk ndëshkohen në raport me kandidatët tjerë.

Adaptimi i testeve është duke u bërë praktikë e zakonshme për punëdhënësit. Mos nguroni të pyesni për këtë gjë.

6) Vetë-vlerësimi

Nëse pas gjithë këtyre hapave, ju ende nuk keni gjetur vend pune, vazhdoni me hapin e gjashtë ku ju rivlerësoni metodat tuaja për të identifikuar çka ju pengon nga përmbushja e qëllimeve tuaja.

Mbani mend që ju punëdhënësit i ofroni aftësitë tuaja, jo paaftësitë tuaja.

Ky vetë-vlerësim do t'ju mundësojë të përmirësoni disa procedura ose qëndrime. “A është e realizueshme kjo objektive? A disponoj me aftësi dhe përvojën e duhur për këtë lloj pune? Çfarëgabimesh kamë bërë gjatë intervistimit?” Gjatë kësaj faze shpeshherë është e nevojshme ndihma e këshilluesit për punësim me qëllim të qartësimit të asaj çka ka ndodhur. Gjatë kësaj faze, kërkuesit e punës shpesh do të ndryshojnë sjelljen e tyre dhe do të risin mjaft mundësitë e tyre për të gjetur vend pune.

“Strategjia për kërkimin e punës” për njerëzit me dëmtim të palcës kurrizore në të vërtetë nuk është aq e ndryshme nga ajo e kërkuesve të tjerë të punës: në fund, të gjithë ne kemi ideale dhe ëndëra të njëjta. Sidoqoftë, kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet adaptimit të qëndrimit tuaj për tu sjellur me punëdhënësit e ardhshëm: ju duhet të njoftoni ato për gjendjen tuaj fizike dhe t'i çlironi ata nga frika, shqetësimi ose paragjykimet që burojnë nga e panjohura. Ju do të përfitonit nga të kuptuarit e pengesave të cilat mund t'i hasni si dhe nga identifikimi i zgjidhjeve të mundëshme.

Eliminoni pengesat

Ajo çka i dallon (i shquan) kërkuesit e punës me dëmtim të palcës kurrizore janë pengesat që ata mund të hasin gjatë përpjekjeve në drejtim të integritimit në trajnim dhe në punë. Këto vështirësi shtesë, që lidhen me gjendjen e tyre fizike, shpeshherë janë shkaktari më i madh i diskriminimit dhe përjashtimit të tyre nga vendi i punës. Pikërisht kjo gjë e bën të rëndësishme identifikimin e tyre me qëllim të zvogëlimit të ndikimeve të tyre negative në hapat drejt punësimit tuaj.

Madje edhe sot, paragjykimet ende janë një ndër shkaqet kryesore të këtij përjashtimi. Ato bëjnë që aftësitë e përdoruesve të karrocës të jenë të mbi ose nën vlerësuar. Këto në përgjithësi janë keqkuptime. Për shembull, është besuar që njerëzit me dëmtim të palcës kurrizore vazhdimisht nuk janë në punë për shkak të sëmundjes së tyre. Asgjë nuk mund të ndihmojë përveç të vërtetës: statistikave tregojnë të kundërtën. Punëdhënësit kanë po të njëjtat bindje si ajo e popullatës në përgjithësi. Përalla të tepërta të parëndësishme pozitive ose negative. Edukimi i punëdhënësve, pjesërisht është edhe detyrë e juaja. Ju mund të ndikoni në ndryshimin e të menduarit të tyre gjatë intervistimit tuaj. Gjithashtu, të qenit vetë ju dhe të zhvilluarit e marrëdhënieve të harmonizuara me kolegët në punë do të ndihmojë në ndryshimin e këtyre kuptimeve.

Prania e mjeteve të përshtatura të transportit si dhe parkimi i rezervuar janë hapa esenciale në rrugën e punësimit. Derisa pjesa më e madhe e njerëzve me dëmtim të palcës kurrizore mund të adaptojnë veturat e tyre në falenderim të ndihmës financiare nga qeveria, shumë të tjerë nuk kanë mundësi ti blejnë ato. Ata mbeten të varur nga sistemet e adaptuara të transportit që kanë sisteme me orar të caktuar (të rreptë) ose që kërkojnë rezervime (në disa raste edhe 48 orë më parë) e cila e bën gati të pamundur gjetjen e punës (shkuarjen në intervistime ose teste seleksionuese). Për personin me dëmtim të palcës kurrizore, të disponuarit me mjet transporti mund të jetë faktor vendimprurës nëse kërkimi për punë do të jetë ose jo i suksesshëm. Përshtatshmëria arkitektonike dhe adaptimi i vendit të punës gjithashtu janë faktorë përcaktues kur pranoheni në punë.

Shpeshherë, punëdhënësi do të përdorë faktin se kompania nuk përjashton asnjë mundësi për t'ju pranuar në punë. Kompanitë të cilat dëshirojnë të bëjnë përshtatjen e vendeve të punës, për disa ndryshime dhe adaptime të nevojshme mund të marrin ndihmë financiare përmes programeve ekzistuese federale dhe provinciale. Këshilluesi i specializuar për punësim është i vetëdijshëm për programet ekzistuese dhe mund t'ju japë informata mbi burimet në dispozicion. Këshilluesi zakonisht takohet me punëdhënësin për t'i treguar atij/asaj se çfarë ndryshime janë të mundshme. Ajo çka duhet mbajtur mend është se shpenzimet e rinovimit shpesh janë minimale si dhe vizitimi i kompanisë, bën që zgjidhjet zakonisht të jenë të thjeshta dhe të lira. Nëse punëdhënësi dëshiron t'ju pranojë në punë për shkak të aftësive të cilat ju i keni demonstruar, ai ose ajo do të bëjë zakonisht krejt çka është e mundur të bëjë vendin tuaj të punës të përshtatshëm.

Si përfundim, mund të lindin edhe shumë pegesa të tjera: artikujt në marrëveshtjen e përgjithshme të cilat mund të kenë ndikim në kthimin tuaj në kompani, orari i punës i cili ndryshon, vendosja në listën për t'ju sjellë ndër mend (kur ekzistojnë vende pune), procesi i selektimit dhe pranimit në punë të papërdhtatshme, reagimi i kolegëve në punë etj. Sidoqoftë, ju duhet mbajtur në mend se për çdo problem ekziston zgjidhje dhe, përkrahja nga burime të specializuara është faktor vendimtar për ripunësim të suksesshëm. Disa punëdhënës janë më të zgjuar dhe më të sensibilizuar dhe varësisht nga kjo do të bëhet edhe ofrimi i shërbimeve. Përcaktimi dhe aftësia juaj për të treguar shkathtësitë e juaja do të përcaktojë suksesin e reintegrimit. Është çështje e pikëpamjeve të dyanshme.

.....

Kualitetet dhe aftësitë që kërkohen nga punëdhënësi

Ndryshimet e mëdha në tregun e punës, të shkaktuara nga globalizimi i tregjeve dhe prezantimi i teknologjisë së re, nënkupton se fuqia punëtore kanadeze duhet të përgaditet për tu ballafaquar me kërkesa të reja. Mbi dhe nën minimumin e kualifikimeve të cilat janë të nevojshme për të siguruar punë, punëdhënësit dëshirojnë kandidatë të cilët tregojnë aftësi të mëdha për tu përshtatur ndryshimeve si dhe pjekuri të madhe në pikëpamjet e tyre personale dhe sociale. Mos hezitoni që të ndani me punëdhënësin eksperiencën tuaj si person me dëmtim të palcës kurrizore, sfidat për rehabilitimin dhe motivimin e fuqishëm për tu kthyer në jetën tuaj aktive profesionale. Kjo është dëshmi për aftësinë tuaj për tu adaptuar situatave të reja dhe për të gjetur zgjidhje për problemet që lindin.

Profili i aftësisë për të punuar, e cila është më e rëndësishmja për punëdhënësit, bazohet në aftësitë akademike të fituara kohët e fundit (njohuri specifike për punën në fjalë, aftësi të mira komunikuese, aftësia për të zgjidhur probleme të ndërlikuara, dhe dëshira për të mësuar) në kualitetet dhe aftësitë personale (qëndrimi dhe sjellja pozitive, ndjenja e përgjegjësisë, iniciativës, aftësia për të adaptuar, për të ndryshuar dhe inicuar ide të reja) si dhe në aftësinë për të punuar me të tjerët në grup. Prandaj, siç mund të shihni, përmes “punës që bëni me veten tuaj” ju zhvillon aftësitë të cilat çmohen nga punëdhënësi.

Mund të keni vënë re se paaftësitë e kandidatit mund të kenë pak ose aspak ndikim në vetë procesin e punësimit, përderisa për punëdhënësin kandidati ka sukses në demonstrimin e aftësive dhe kualiteteve të tij/saj. Sidoqoftë, çdo këshillues i specializuar për punësim mund të bëjë një anekdotë për situatat ku paaftësitë kanë qenë mjaft evidente në ndërveprimin punëdhënësi/kandidat. Ja një shembull: një paraplegjik me pak arsimim ose përvojë profesionale, kontakton me drejtorin për resurse njerëzore të një kompanie të madhe e cila është e specializuar në prodhimet për komunikim. Ai shpjegon se shërbimet e specializuara për punësim e kanë njoftuar për të kërkuar punë atje ngaqë kanë të dhëna që ata punësojnë persona që janë përdorues të karrocës. Drejtori i resurseve njerëzore i përgjigjet se të qëniet në karrocë nuk paraqet kualifikim për punë. Madje edhe nëse kompania i përmbahet parimeve për mundësi të barabartë në programin për punësim, kjo kompani punëson inxhinjerë të kualifikuar të elektronikës, sekretarësh pa marrë parrasyshë paaftësinë, dhe jo për shkak të paaftësisë tyre.

.....

Përkrahja e posaçme

Në shoqatën e paraplegjikëve të Kanadës këshilluesi për resurse njerëzore/për punësim ka zhvilluar ekspertizë të veçantë për të mbështetur procesin për vende të punës për persona me dëmtim të palcës kurrizore.

“Duke iu falenderuar shërbimeve që kam pranuar dhe ndihmës që më është dhënë nga këshilluesi, fillova të ndihem më pak si person me paaftësi dhe më shumë si person me aftësi,” shpjegon Natalie. “Pas këshillimit zbulova se në cilin sektor të shkoj. Duke ndjekur disa sesione për këshillim personal, rifitova vetëbesimin. Paraqita kurikulumin tim disa punëdhënësve dhe, pas disa intervistimeve, përfundimisht gjeta punë si sekretarësh. Më pëlqen të punoj me kompjuterë. Në të njëjtën kohë, jam e vetëdijshme për kërkesat e tregut të punës, prandaj vazhdimisht e plotësoj edukimin tim.”

Këshilluesi do t’ju ndihmojë në vlerësimin e aftësive tuaja për punësim, vlerësimin e të mirave dhe dobësive tuaja si dhe t’ju drejtojë në burimet e përshtatshme për të përmirësuar aftësitë tuaja. Pas kësaj, këshilluesi mund t’ju prezantojë juve tek punëdhënësit, t’ju pregadisë për intervistim dhe të vizitojë vendin e punës për të parë nëse ai është i përshtatshëm për karrocë dhe nëse janë të nevojshme ndryshime. Këshilluesi ju përkrah gjatë gjithë procesit për punësim. Shpeshherë kjo bëhet brenda kornizës së përkrahjes që ju të ndryshoni qëndrimet e tua drejt vetes suaj dhe punëdhënësit: kjo është vetë bisimi.

.....

Si mund të njihni mundësitë tuaja: bëjeni zgjedhjen tuaj

Në shoqërinë tonë, në zgjedhjen që bën personi për profesionin e tij mund të ndikojnë shumë faktorë. Personi në fjalë duhet të zgjedhë aktivitetet e tij në pajtim me arritjet personale dhe gjithashtu duhet të ketë në konsideratë se transformimi i tregut të punës ka bërë format tradicionale gjithnjë e më të rralla dhe më konkruuese. Një shembull i

industrisë jotradicionale është turizmi dhe kultura e cila është zhvilluar në një burim mjaft të rëndësishëm për punësim. Duke paraqitur atmosferën e ndryshueshme ekonomike dhe sociale, shumë individë, nuk kërkojnë më punë me orar të plotë.

Për disa njerëz, duke përfshirë këtu edhe njerëzit me dëmtim të palcës kurrizore, edhe aktivitetet e tjera përveç atyre me pagë mund të jenë burim i stimulimit për ngritjen e vetë vlerësimit, të kënaqësisë personale dhe sociale si dhe lirisë për të krijuar. Në të gjitha vendet e idustrializuara, puna vullnetare dhe puna në komunitet nxisin një sasi të madhe aktivitetit ekonomik, deri në pikën ku këto projekte janë subvencionuar nga qeveritë në bashkëpunim me ndërmarrjet private. Për shembull, organizatat për të drejtat e njeriut ose organizatat jo-profitabile të cilat ofrojnë shërbime për postet e vullnetarëve ose ndonjëherë punë.

Sophie shpjegon se ajo ka filluar si ilustruese për revistën e organizatës për vetë-ndihmë para se të punësohej. Puna vullnetare ju jep mundësinë të provoni vlerat tuaja: “Ju keni në disponim gjashtë muaj për t’ju treguar se nuk mund t’ia dalin mbanë pa ju!” kjo është frazë kyçe për një person i cili është i angazhuar në ndonjë punë vullnetare. Vazhdimi i arsimimit pas përfundimit të shkollës së mesme gjithashtu është alternativë për punën me pagë. Qasja në dije dhe trajnimi i paraprinë zhvillimit të aftësive personale dhe aftësive të cilat krijojnë vetë-besim dhe na hapin mendjen tonë ndaj botës që na rrethon. Kur ballafaqoheni me profesorët dhe studentët rekomandohet adoptimi i një qëndrimi të pavarur dhe të hapur (sinqertë): këtu gjithashtu, do të gjeni paragjykime të cilat janë ushqyer nga injoranca.

Aktivitetet e tjera përveç atyre me pagë mund të jenë shkaqe për stimulimin e rritjes së vetë besimit, të kënaqësisë personale dhe asaj shoqërore si dhe lirisë për kreativitet

“Kisha shumë vështirësi për tu pranuar nga nxënësit e tjerë,” shpjegon Michaeli, i cili është kuadriplegjik. “Ndjehesha ndryshe dhe kur erdhi koha për të punuar në grup përfundova vetëm. Një ditë, pyeta mësuesin të më lejojë të flas para klasës: shpjegova për aksidentin tim, për qëndrimin tim në spital dhe rehabilitimin tim. Qëndrimi i shokëve të mi të klasës u ndryshua. Që nga ai moment, u bëra person i vërtetë.” Në të ardhmen, do të ekzistojnë mundësi për punë në fushën e edukimit, trajnimit dhe edukimit të të rriturve, si dhe në sektorin për zhvillim personal.

Vetëmësimi i shkathtësive personale dhe profesionale gjithashtu mund t’i paraprijë punës me kontratë ose të punuarit nga zyrë e largët (e veçuar), siç është nga rezidenca private, e cila do të eliminojë çdo problem të transportimit ose pengesave arkitektonike. Është vlerësuar se në forcën e përgjithshme punëtore, puna kontraktuese përbën 15 % të punës me pagesë dhe ky është një trend në rritje e sipër. Për shembull, disa njerëz ofrojnë aftësitë e tyre sekretareske, redaksionale ose korrektorese; të tjerë mund të bëjnë telemarketing nga shtëpia e tyre.

“Duke iu falenderuar kompjuterëve dhe mundësive në ambientin shtëpiak, mund të krijoj postere reklamuese nga zyra e shtëpisë time,” thotë Sophie.

Alternativë tjetër në rritje është ofrimi i shërbimeve tuaja përmes fillimit të biznesit tuaj të vogël. Një numër i madh i vendeve të punës në ditët e sotme janë krijuar nga bizneset e vogla dhe ato të mesme, ku dalja me ide origjinale është më e rëndësishmja. Shërbimet e CPA-së për punësim veç më kanë ndihmuar disa njerëz me dëmtim të palcës kurrizore të fillojnë me bizneset e tyre, për shembull, në shërbimet kompjuterike dhe ato botuese.

Sektorët në zhvillim (ngritje)

Për të zmadhuar deri në maksimum gjasat e suksesit tuaj, njohja e tregut të punës mund t'ju ndihmojë mjaft në drejtimin e progresit tuaj drejt trajnimit dhe karrierës. Ekziston një mendim i përgjithshëm se në cilët sektorë të shoqërisë sonë janë më të mëdha mundësitë për punësim. Sektorët e tillë janë:

- Kompjuterët dhe programimi i tyre;
- Elektronika dhe elektronika digjitale;
- Teknikat për prodhim të automatizuar;
- Automatizimi i zyrës dhe gjuhët;
- Edukimi vijues, riklasifikimi dhe ringarkimi me detyra;
- Prodhimet farmaceutike dhe biokimike;
- Teknologjia inxhinierike dhe biomjeksore;
- Shërbimet e prodhimit, marketingut dhe ato për klientët, duke përfshirë këtu marketingun televiziv;
- Sektori I shëndetësisë dhe kujdesi shtëpiak;
- Shërbimet për punësim;
- Shërbimet financiare;

Siç mund të shihni, asnjëra nga këto fusha nuk përjashton nga mundësia njerëzit me dëmtim të palcës kurrizore për tu përfshirë në tregun e punës.

Përfundimi

Pra, përveç punëve tradicionale ekzistojnë edhe zgjidhje të tjera që mund të ketë parasyshë një person me dëmtim të palcës kurrizore. Faktori I vetëm kufizues është imagjinata e vetë personit. Nga vetë individi varet zhvillimi i strategjisë personale për tu kthyer në aktivitetet shoqërore stimuluese, riformuluese, në pajtim me potencialin, vlerat bazë dhe me energjinë që ai / ajo dëshiron të investojë. Çdokush ka potencial i cili mund të zhvillohet dhe që është i kufizuar vetëm nga restriksionet të cilat vetë imponohen.

“Gjetja e vendit tuaj” është e mundshme për çdo individ, duke përdorur fuqinë dhe dobësitë që posedojmë.”

Përfundimisht, dëshirojmë të theksojmë sa e rëndësishme është për njerëzit me dëmtim të palcës kurrizore të planifikojnë strategji personale për tu rikthyer në jetën aktive dhe të pavarur. Njohja e mënyrës se si të caktohen qëllimet afat shkurta, afat mesme dhe afat gjatë shpeshherë paraqet çelësin e suksesit. “Të kërkuarit e punës kuptimplotë dhe jo vetëm punës” karakterizon qasjen e re në “gjetjen e vendit tuaj” në shoqëri.